



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:166135

Datë: 30.11.2023

Numri i dokumentit: 04995847



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.852/20

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnya në çështjen penale kundër të pandehurve I. H. dhe F. H. nga Mitrovica, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1787/19 të datës 27.11.2020 për shkak të veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 29.11.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit I. H., me mbrojtës av. Diar Dinaj dhe te pandehurit F. H., me mbrojtës av. Avdi Dinaj, me datë 29.11.2023 shpalli ndërsa me datë 30.11.2023 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

I. H., i atësisë S. dhe amësisë H., e vajzërisë H., i lindur me dt., në Mitrovicë, ku edhe jeton ne rr. “R. Z.”, ka të kryer shkollën e lartë profesionale, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal posedon nr. tel 044/...-..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

F. H., i atësisë S. dhe amësisë H., e vajzërisë H., i lindur me dt., në Mitrovicë, ku edhe jeton ne rr. “R. Z.”, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike , i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal posedon nr. tel 044/...-..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLEN FAJTOR

Për shkak se :

I. I pandehurit I. H.:

Me datën 05.08.2019 rreth orës 18:15 në kafiterinë “M.” në rr. A. Q. në Pejë, seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë apo gjeste se do të i shkaktoj ndonjë të keqe dhe se do ta dëmtoj me armë të zjarrit e me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë ne atë mënyre që : pas një konflikti verbal mes te pandehurit I. H. dhe D. K. dhe E. K., e pasi qe E. K. i drejtohet të pandehurit se rastin kemi me paraqitë ne polici në Suedi, atë moment i pandehuri ju drejtohet te dëmtuarave D. dhe E. me fjalët : “jo me polici por ndalu se tani të tregoj unë” dhe “kam me ua kajt nenën” duke e shfaq dhe pastaj duke e nxjerr armen nga brezi e me këtë duke ju shkakuar frikë dhe ankth te dëmtuarave E. K. dhe D. K..

-Me çka ka kryer veprën penale “Kanosje” nga neni 181 par.2 te KPRK-se.

II. I pandehurit F. H.

Në kohen dhe vendin e lartëcekur si ne pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi, seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë se do ti shkaktoj ndonjë të keqe me privim nga jeta e me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, në atë mënyre që: pasi që ish bashkëshortja e tij-e dëmtuara E. K. i drejtohet të pandehurit F., i drejtohet te dëmtuarës në gjuhën suedeze me fjalët “kam me marr armën dhe kam me ju vra te gjithëve” me ç’rast i shkakton frikë dhe ankth të njëjtës.

-Me çka ka kryer veprën penale “Kanosje” nga neni 181 par.2 te KPRK-se.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurit I. H. i shqipton DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 800 (tetëqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritët me njëzet (20) euro gjobë.

II. Të pandehurit F. H. i shqipton DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritët me njëzet (20) euro gjobë.

III. Obligohen të dënuarit secili veç e veç qe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 euro ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 27.11.2020 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1787/19 kundër të pandehurve I. H. dhe F. H. për shkak të veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së ndërsa për të pandehurit D. K. dhe E. K. për veprën penale në bashkëkryerje Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.1 nen-par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-se.

Gjykata e mbajti seancën shqyrtimit fillestar me date 12.04.2023 dhe me qenë se nuk mundi të siguroj prezencën e të gjithë të pandehurve, pas marrjes së mendimit të palëve prezent dhe në kuptim të nenit 35 të KPRK-së e veçoj procedurën ndaj të pandehurve D. dhe E. K., ndërsa e vazhdoj procedurën ndaj të pandehurve I. dhe F. H., të cilëve u dha mundësia për kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhjen e aktakuzës.

Kjo gjykatë me datë 29.11.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësore në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit I. H., me mbrojtës av. Diar Dinaj dhe të

pandehurit F. H., me mbrojtës av. Avdi Dinaj, në të cilën seancë të pandehurit u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësve në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “ Pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarve I. H., dhe F. H., gjate këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor u vërtetuar përtej dyshimit mirë të bazuar se të akuzuarit të sipër shënuar janë kryes të veprave penale për të cilat akuzohen dhe këtë konkludim e mbështesim në të gj itha provat personale dhe materiale të përshkruara si në faqen 4 dhe 5 të kësaj aktakuze, andaj duke marr parasysh se të akuzuarit pranimin e fajësisë e deklaruan në përputhje të plotë me dispozitat ligjor të nenit 242 të KPPRK-së, ër faktin se pranimin e fajësisë e deklaruan në mënyrë vullnetare, pa ndikim dhenë mbështetje në faktet e çështjes që përmban kjo aktakuzë, nga Gjykata kërkon që të akuzuarit në fjalë ti shpall fajtor, ti dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzime të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese, ndërsa në kuptim të depozitave ligjore të nenit 70 par.2 pika 2.5 të KPRK-së, për të pandehurin I. H., si rrethanë rënduese gjykata të vlerësoj faktin se nga vepra penale e kryer nga I. H. kemi dy persona të dëmtuar”.

Mbrojtësi i te pandehurit I. H., av. Diar Dinaj deklaroi: “Pas konsultimit të mjaftueshëm dhe pranimi të fajësisë nga ana e të mbrojturit tim konsideroj se ekzistojnë një mori rrethanash lehtësuese e që vetë pranimi i fajësisë është rrethanë tejet lehtësuese, dua të theksoj se i njëjti është familjar, baba i pesë fëmijëve, mbajtës i familjes, andaj edhe gjykatës me rastin e matjes është dënimit ti shqiptoj një dënim me gjobë sa më të vogël të mundshme, me ç’rast gjykatës ja dorëzoj disa dokumentacione mjekësore për sëmundje e të mbrojturit tim për të cilën ka shpenzime, siç janë raporti i komisionit konzuluar i reumatologëve i dt.07.03.2023, raport nga kontrolli e kryer tek Dr. B. D. me dt.03.04.2023, dhe raport i kryer tek dr.B. D, i dt.17.janar.2023. Andaj edhe gjykatës i propozojmë që ti shqiptohet një dënim me gjobë”.

Pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, i pandehuri I. H. deklaroi “Pajtohem me deklarimin e mbrojtësit tim dhe ndihem shumë keq për atë që ka ndodhur dhe kërkoj nga gjykata të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë”.

Mbrojtësi i te pandehurit F. H., av. Avdi Dinaj deklaroi: “Duke pas parasysh faktet se i pandehuri në të gjitha fazat e procedurës e ka bërë pranimin e fajësisë, ndërsa në anën e tij ekzistojnë edhe rrethana tjera lehtësuese se më parë nuk ka qenë në gjykatë, ndaj tij nuk zbatohet procedurë për ndonjë veprë tjetër penale, është rasti i parë që vie në konflikt me Ligji, i propozoj gjykatës që ti shqiptoj një dënim me gjobë duke konsideruar se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe të merret parasysh fakti se është penduar për veprën e kryer”.

I pandehuri F. H. deklaroi: “Pajtohem me deklarimin e mbrojtësit tim dhe ndihem i penduar për atë që ka ndodhur dhe Ju kërkoj falje Juve si gjykatë, dhe Ju premtoj se nga ana ime nuk do të përsëritet më një gjë e tillë, sepse tashmë unë kam ecur me jetën time , jam martuar dhe po krijoj familje”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor të pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurve vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë si nedispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilin detyrohen ta paguajnë në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që të pandehurit nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin I. si rrethanë renduese e kemi shkallën e lartë të dashjes e cila shprehet përmes shfaqjes se revoles gjate kryerjes se veprës penale dhe faktin se vepra penale përfshin më shumë së dy viktimat, ndërsa për të pandehurin Fatmir si rrethanë renduese kemi faktin se vepra penale të cilën e ka

kryer përfshin dy ose më shumë viktime, ndërsa si rrethana lehtësuese për te dy te pandehurit gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit në seancën e shqyrtimit gjyqësorë dhe keqardhjen e shfaqur nga të pandehurit me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurve të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjorbë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënës ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjorbë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjorbë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Dallimi i shprehur në lartësinë e dënimit me gjorbë në rastin e të pandehurit I. H., ka ardhur në shprehje duke marrur parasysh se në lidhje me të njëjtin kemi pasur me shumë rrethana renduese, siç u përshkruan më lart.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurve I. H. dhe F. H. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.852/20, me datë 30.11.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnja

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.